

AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“XVS 2” SHPK

Më datë 01/09/2022, themeluesit e mëposhtëm:

Znj.Suela Ereqi, e bija e Skënder-it, lindur më 21/04/1995 në Fier dhe banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga Karta e Identitetit me Nr.Personal J55421077Q.

Z.Bruno Papaj, i biri I Sotiraq-it, lindur më 09/10/1993 në Fier dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga Karta e Identitetit me Nr.Personal J31009072J.

Z.Skënder Hoxhaj, i biri I Namik-ut, lindur më 10/10/1994 në Fier dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga Karta e Identitetit me Nr.Personal J41010122J.

Z.Philipp Koronowski, i biri I Andrea-s, lindur më 04/04/1996 në Wuppertal dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga Karta e Identitetit me Nr.Pasaporte C6ZZ3ZYFF.

Kanë vendosur krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe nënshkruajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar, nga përcaktimet në këtë akt themelimi dhe nga statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti.

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Themelimi, Forma dhe Emërtimi I Shoqërisë

Krijohet shoqëria “XVS 2” SHPK

Shoqëria është Person Juridik Privat dhe një Shoqëri me Pergjegjësi të Kufizuar

Shoqëria do të paraqitet me emrin **“XVS 2” SHPK**. Ky emërtim është i vetmi i shoqërisë dhe përdoret në të gjitha regjistrimet, transaksionet, marrëveshjet dhe komunikimet e saj me të tretë apo shtetin dhe është i vlefshëm si jashtë dhe brenda vendit.

Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 2
Personaliteti Juridik

Shoqëria fiton personalitet juridik pasi të jetë regjistruar në QKR, në përputhje në kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimitarise së saj.

Neni 3
Objekti I veprimitarise së shoqërisë

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimitarise:

" Ndërtimin e centraleve Fotovoltaike (Diellore), Hidroteknike etj, te cilat bejne te mundur shfrytezimin e energjise qe gjendet ne natyre dhe qe jane te rinovalueshme. Prodhim i energjise elektrike nga burimet e rinovalueshme Fotovoltaike (Diellore). Shitja e energjise elektrike klienteve dhe blerja e energjise elektrike nga operatore te ndryshem privat apo shteteror brenda dhe jashte vendit. Transmetimi i energjise elektrike ne sistemin e tensionit te larte, funksion i cili perfshin transmetimin ose interkonjeksionin nderkombetar. Perdorimin e sistemeve te linjave, strukturave mbeshtetese dhe pajisjesh transformuese per transmetimin e energjise elektrike. Shperndarjen, transportin e energjise elektrike ne sistemet shperndarese te tensionit te mesem dhe te ulet, duke patur parasysh shperndarjen deri tek konsumatori i fundit. Shërbimet konsulence dhe komisionit financiar të ndërmjetësimit për blerjen, shitjen, prodhimin instalimin e sistemeve të ripërtëritshme të energjisë, formave diellore, turbinave të erës dhe sistemeve hidroelektrike të shfrytëzuara për vete ose për llogari të palëve të treta, marketingun dhe prodhimin e sistemeve elektronike (Software), komponentët e sistemet periferike për burimet e rinovalueshme. Tregtimi dhe mirëmbajtjen e të gjitha llojeve të makinerive elektromekanike, ajër të kondicionuar, makineri termohidraulike, tregtimi e materialeve të ndërtimit si dhe ndërtimin e marketingun e makinerive të teknologjisë së lartë, elektrike dhe pajisjet elektronike. Kryerja e studimeve për ngrohje, gaz, pajisje hidraulike dhe instalimet elektrike. Ndermjetsim financimi(kredi) me institutet financiare, bankat e nivelit te dyte, te huaja ose vendase per huadhenie per vete ose pale te treta. Sherbim konsulence ne fushen juridike, financiare dhe teknologjise se informacionit dhe komunikimit (TIK).

Shoqëria brenda hapsirave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryeje cdo operacion tregtar dhe finansiar që lidhet drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimitarise së saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimitarive të tjera, krijimin e sipërmarrjeve të reja dhe pjesmarrjen në sipërmarrje të tjera, brenda dhe jashtë vendit. Shoqëria mund të kryej edhe aktivitete të tjera shtesë, me qëllim përbushjen e veprimitarise të saj kryesore në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi".

Neni 4
Selia e shoqërisë dhe degët

Selia e shoqërisë do të jetë në Fier në adresën: Rruga L" Sheq i Madh", Nr. Pasurie 155/48, Ndërtesë dy katëshe, Zona kadastrale Nr. 3981.

Neni 5
Kohëzgjatja e shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë **"XVS 2" SHPK** është e pakufizuar dhe fillon në momentin e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

KAPITULLI II
KAPITALI THEMELTAR
Neni 6

Kapitali Themeltar i shoqerise perbehet nga te holla qe kapin vleften 40,000 (dyzetë) lekë nga te cilat:

*Ortaku themelues i Shoqërisë **"XVS 2" SHPK, Znj. Suela Eraqi** është zotërues e 1 (një) kuote me vlerë 10.000 (dhjetë mijë) lekë, e cila përbën 25% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.*

*Ortaku themelues i Shoqërisë **"XVS 2" SHPK, Z. Bruno Papaj** është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 10.000 (dhjetë mijë) lekë, e cila përbën 25% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.*

*Ortaku themelues i Shoqërisë **"XVS 2" SHPK, Z. Skënder Hoxhaj**, është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 10.000 (dhjetë mijë) lekë, e cila përbën 25% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.*

*Ortaku themelues i Shoqërisë **"XVS 2" SHPK, Z. Philipp Koronowski** është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 10.000 (dhjetë mijë) lekë, e cila përbën 25% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.*

Neni 7
Ndryshimi I kapitalit themeltar

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Ortakëve themelues.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve nëpërmjet akteve ligjore.

KAPITULLI III
ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organë Vendimarrës

1. Asambleja e Përgjithëshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për cështjet e mëposhtme:

- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

- Ndryshimin e Statutit;
- Emërimin dhe shkarkimin e administratorit/ve;
- Emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Ceshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për cështjet e përcaktuar për miratimin e pasqyrave financiare, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentave përkatës.

3. Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Ortakët e shoqërisë. Të gjitha vendimet e marra nga Ortakët e shoqërisë regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënët e të cilët nuk mund të ndryshohen apo të fshihen. Duhen regjistruar në vecanti, por pa u kufizuar në to, vendimet:

- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- Investime;
- Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund ti kundrejtojë pavleshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvec rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

4. Ortakët e shoqërisë mund të përfaqësohen edhe nga një tjetër person, nëpërmjet prokurës.

5. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

Neni 9 Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e Statutit vendosen nga Ortakët e shoqërisë.

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 10 Administrimi

Shoqëria administrohet nga Administratori: Z.Skënder Hoxhaj, i biri I Namik, lindur më 10/10/1994 në Fier dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga Karta e Identitetit me Nr.Personal J41010122J.

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- Kujdeset përmes mbajtjen e saktë e të rregullit të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet përmes shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme përmiratim;
- Kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet në ligjin përmes Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- Raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecantë përmes veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Përfaqëson shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshirë këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve;
- Administratori angazhon shoqërinë në marrdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj;
- Administratori ka të drejtë të nënshkruajë kontrata të ndryshme në emër e përmes llogari të Shoqërisë, përfshirë këtu kontratat e qerasë, shitjes, blerjes, kredive a hipotekimit të pasurive të paluajtshme, të nënshkruajë aktet e themelimit të shoqërive të tjera ku Shoqëria është ortak;
- Të nënshkruajë të hartoje cdo document e të kryejë në emër të Shoqërisë cdo veprim përballetë të gjitha Bankave shqiptare apo të huaja në lidhje me celjen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse të Shoqërisë, nënshkrimi i kontratave të ndryshme bankare përmes financimin e Shoqërisë si dhe të kryejë veprime tërheqje e derdhje shumash nga këto llogari pa limit;

Neni 11 **Viti Financiar**

Viti finanziar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.
Përjashtimisht viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylli më 31 Dhjetor.

Neni 12 **Baza ligjore**


Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislativit shqiptar.
Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe cfarëdo ligji tjeter specific në Republikën e Shqipërisë.

Neni 13
Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u hartua në 4 kopje me përmbajte dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare "**XVS 2**" SHPK.

ORTAKËT THEMELUES

Suela Ereqi



Bruno Papaj



Skënder Hoxhaj



Philipp Koronowski

